



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 2010/1
Prishtinë, më 19. 01. 2010, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri – kryetar, Nerxhivane Dauti, Hajredin Hyseni, Radmila Vujovic, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Danush Ademi, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

Pjesëmarrës të tjerë: Rrezarta Ahmeti – KDI, Nexhat Shatri - Zyra e Presidentit, Shqipe Arifaj – Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Lejla Selimi – OSBE.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj – koordinators dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e drejtoi Nerxhivane Dauti që konstatoi se ishin plotësuar kushtet, në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për mbajtjen e mbledhjes.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22. 12. 2009,
3. Miratimi Raportit të punës të Komisionit për vitin 2009,
4. Hartimi i Planit të punës të Komisionit për vitin 2010,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje,
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Komisioni e hoqi pikën e tretë nga rendi i ditës, me arsyetim se me strategjinë e Qeverisë të bëhet edhe planifikimi i punës së Komisionit

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 22. 12. 2009

Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e datës 22. 12. 2009

3. Miratimi i Raportit të punës të Komisionit për vitin 2009

Kryesuesja – U tha anëtarëve të Komisionit se vërejtje për Raportin e punës të Komisionit për vitin 2009 mund t'i paraqesin, në mënyrë që Raporti të jetë sa më gjithëpërfshirës.

Drita Maliqi - Tha se në faqen e dytë të Raportit nuk gjendet emri i subjektit politik që ajo e përfaqëson (LDD). Vërejtja e dytë, për bashkëpunim me OSBE-në, ishte e shënuar në fillim të faqes së tretë të Raportit.

Hajredin Hyseni – Ishte i mendimit se Raporti do të duhej të përfshinte dëgjimet publike, vizitat studimore dhe takimet me Avokatin e Popullit. Kërkoj të hiqet nga Raporti pjesa ku bëhet fjalë për fushëveprimin e Komisionit, ngase e ngarkon tekstin.

Ibrahim Makolli - Tha se raportet nuk bëhen vetëm për komisione, por në to mund të ketë qasje edhe opinioni më i gjerë, sepse ndodh që ata të mos i dinë rolin dhe fushëveprimin e Komisionit. Pra, nuk është e tepërt të përkruhen objektivat dhe fushëveprimi. I bëri vërejtje pjesës së Raportit, në të cilën në formë tabelare paraqitet numri i ankesave. Ishte i mendimit se ato nuk do të duhej të përfshiheshin, ngase është raport publik.

Ismet Beqiri - I cili e mori drejtimin e mbledhjes – I njoftoi anëtarët se ky është një version i parë i Raportit, sigurisht në të do të përfshihen vërejtjet dhe sugjerimet. Kërkoj nga ata që vërejtjet konkrete t'ia dërgojnë me shkrim administratës që t'i fusë në Raport.

U tha se Raporti në mënyrë të kënaqshme e pasqyron punën njëvjeçare të Komisionit. Pas një diskutimi Komisioni e miratoi Raportin e punës për vitin 2009 dhe vendosi që vërejtjet të përfshihen në të.

4 Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtje nga dhuna në familje

Ismet Beqiri – Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja nga dhuna në familje me anë të masave të posaçme ligjore, krijimi i mekanizmave përkatës për mbrojtjen,

mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave. Sot vetëm do të njoftohemi se Komisioni do ta procedojë atë.

Hajredin Hyseni - Ishte i mendimit të formohet grupi i punës që të shqyrtohet Projektligji. Si raportues i rekomandoi Komisionit ta emëronte Nerxhivane Dautin raportuese.

Për Projektligjin diskutuan: Drita Maliqi, Ismet Beqiri dhe Nerxhivane Dauti. Ata kontribuan me diskutimet e tyre që Projektligji më gjerësisht t'i përfshijë institucionet relevante. I propozuan Komisionit të mbajë dëgjim publik në mënyrë që vërejtjet dhe propozimet e secilit, që mendohet se janë me interes, të përfshihen në ligj.

Ibrahim Makolli - Tha se Projektligji do të duhej t'i përfshinte më të gjerësisht institucionet relevante, siç janë Policia Kosovës etj., sepse ata e zbatojnë ligjin në praktikë. Ishte i mendimit të mbahet një punëtori, një ose dyditëshe. Më duhet t'i identifikoj institucionet, të cilat merren me këtë çështje, organizatat joqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare, që merren me trajtimin e dhunës në familje.

Komisioni lidhur me këtë pikë e nxori këtë

P ë r f u n d i m

Komisioni e emëroi Nerxhivane Dautin raportuese për Projektligjin e mbrojtjes nga dhuna në familje.

5 . T ë n d r y s h m e

Kryetari - I njoftoi anëtarët e Komisionit për informatën e KPMK-së lidhur me moszbatimin e vendimeve të plotfuqishme nga institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës. Kjo informatë përmban vetëm të dhëna statistikore, prandaj do të kërkojmë që KPMK-ja të sjellë si pjesë përbërëse të kësaj dosjeje, si dhe vendimet e plotfuqishme për secilin rast veç e veç.

Hajredin Hyseni - I njoftoi anëtarët e Komisionit se edhe Komisioni për Administratë Publike, për Administratë Lokale dhe Media e ka trajtuar këtë çështje, prandaj kërkoi të harmonizohen qëndrimet, në mënyrë që të mos ketë kërkesa të njëjta nga KPMK-ja, për të njëjtën çështje. Kërkoi nga ismet Beqiri – kryetar, të takohet me z. Esat Brajshori që të bisedojnë për këtë çështje.

Drita Maliqi - Theksoi se e ka përsëritur disa herë se Gjilani prin me numrin më të madh të personave për këtë çështje. Kam pasur takime me disa kandidatë, të cilët janë në evidencë të KPMK-së për moszbatimin e vendimeve. Shumica e

tyre janë të njoftuar për këtë. Shtoi se Komisioni për të Drejtat e Njeriut, të cilit i janë adresuar, është kompetent.

Ibrahim Makolli - Në vazhdim e njoftoi Komisionin për përmbajtjen e takimit të Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës të Kuvendit. Shtoi se me kërkesë të Komisionit për Integritet Evropian, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione do të jetë një nga komisionet kryesore të Kuvendit dhe do të vendosë për pajtueshmërinë e ligjeve se a janë në harmoni me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Kryetari i Komisionit

Ismet Beqiri